REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 62/17
Datë/Datum. 16.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	**62/17**
PËR:	- Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Universiteti i Prishtinës** - Parashtruesit të ankesës: **N.T.P. "KGT"**- Prishtinë.
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Burim Guri - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **N.T.P. "KGT"**- Prishtinë, me numër protokollit: **62/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e librave në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Angleze" Lot 2, me nr. të prokurimit: 90400/16/032/121.** Kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK) – **Universiteti i Prishtinës.**

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	**16.03.2017**
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e librave në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Angleze" Lot 2, me nr. të prokurimit: 90400/16/032/121,** iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Universiteti i Prishtinës,** si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **N.T.P. "KGT"**- Prishtinë, me numër protokollit: **62/17.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		07.03.2017		08.03.2017		16.03.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të ekspertizës*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **01.03.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **62/16,** e parashtruar nga OE: **N.T.P. "KGT"**- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e librave në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Angleze" Lot 2, me nr. të prokurimit: 90400/16/032/121**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Universiteti i Prishtinës**
Konform nenit 113, të Ligjit Nr. 04/L-042, si dhe konform njoftimit të OSHP-së të datës: 19.11.2014 me nr. prot. 848/14. Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Universiteti i Prishtinës**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues: N.T.P. "KGT"- Prishtinë

Pikat e Ankesës:

Neni 1, pika 2 dhe 3.

AK nuk ishte transparent dhe nuk i është përmbajtur procedurave të Ligjit të Prokurimit Publik

Neni 7, pika 1

AK nuk ka qenë transparent edhe pas kërkesave të vazhdueshme për informata dhe sqarime rreth vlerësimit, mirëpo edhe për kundër kësaj AK ka zgjedhur heshtjen edhe mos transparencën.

Neni 51, pika 1

AK nuk i ka respektuar kriteret që i ka përcaktuar vet.

Neni 54, pika 1,1.1 dhe 1.3

AK edhe pse vendimin e ka marrë me datë 23.01.2017 as nuk na ka njoftu për këtë vendim dhe kemi pritur deri me datë 13.02.2017.

Neni 59, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK ka dështuar që ta themeloj komisionin vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe ka qene dashtë ti njoftoj mbi ligjin, procedurat dhe përgjegjësit e antarëve të komisionit

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në bazë të Ligjit nr. 04/L-0237, ligjit nr. 05/L-068 dhe ligjit nr. 05/L-092, sepse së pari i ka tejkaluar të gjitha afatet kohore të përcaktuara për vlerësim.

Edhe për kundër kërkesës sonë për rishqyrtimin e vendimit për anulim të aktivitetit AK ka nxjerrur vendim për refuzimin dhe kërkesës si të pa bazuar.

AK në arsyetimin e dhënë në vendimin mbi refuzimin ka potencuar dhe ka sqaruar komunikimin mes njësisë kërkuese dhe zyrës së prokurimit.

Nëse analizojmë këtë komunikim mundemi të vërejmë një detaj shumë interesant mbi anëtaret e komisionit të cilët si duket të emëruar si antarë të komisionit vlerësues.

Ky komision sipas komunikimit dhe arsyetimit të AK ka refuzuar që të takohen dhe të vazhdoj vlerësimin pasi që katër herë ua është dorëzuar ftesa që të mblidhen dhe të vazhdojnë vlerësimet.

Nga vetë arsyetimin i AK-në refuzim të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit mbi anulim shihet kjartë komisioni i emëruar në fillim i përbërë nga: Irfan Miftari - kryetar, Imer Dragusha – antar, dhe Lindita Dobruna – anëtare, shihet qartë se për arsyet që ata i dinë kanë ndikuar dhe kanë manipuluar edhe me zotim po edhe me ndikim në antarët tjerë të emëruar.

Gjithashtu vlen të theksohet se ky aktivitet i prokurimit është Ritenderim, pasi që herën e parë vlera e planifikuar për këtë aktivitet ka qenë as e vogël sa nuk ka shprehe interes askush që të ofertoj.

Gjithashtu oferta jonë bazohet në tituj të librave të kërkuar në specifikim në origjinal dhe çmimet e titujve i përcaktojnë vetë autorët dhe se oferta jonë nuk bazohet në manipulime dhe fotokopjime të librave (titujve).

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit dhe duke kërkuar plotësimin e dokumenteve (vërtetimin nga ATK-ja dhe Gjykata) e që kërkohet nga ofertuesit e suksesshëm dhe të përgjegjshëm.

Arsyeja në vendimin për eliminim është e reme sepse në dosjen e tenderit në faqe 13, te pika 2.4 Vlera e parashikuar është 8,500.00 Euro, kurse oferta jonë është 7,968.00 Euro

AK në disa kërkesa për sqarime në lidhje me vlerësimin që është bërë me datë 27.01.2017 dhe me datë 21.02.2017 nuk kemi asnjë përgjigjeje.

Në fund mendojmë se AK ka vepruar në mënyrë tinëzare duke anuluar këtë aktivitet dhe duke mos na njoftuar mbi anulimin duke shpresuar se nuk do ta shihemi njoftimin për anulim në faqen e KRPP-së.

Dëmet materiale:

Dëmi në këtë rast është afërsisht sa vlera e kontratës sepse të gjitha titujt të specifikuar në këtë tender janë të kontraktuara.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP:	20.10.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e Hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Furnizim/vlerë e Mesme
Vlera e parashikuar e kontratës për Lot 2	8,500.00 Euro
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	11.11.2016
Data e hapjes së ofertave:	11.11.2016
Data e njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit në faqen e KRPP-së	06.02.2017

Kriteret për vlerësim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Kërkesat përshtatshmërisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik 04/L-042, për ket Nenit 65 pika 1,2,3,4, dhe 5.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042, Neni 65, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vetem për OE fitues) - kopje.
3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetëm për OE fitues) – origjinal apo e noterizuar.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesat:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Qertifiakata e numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);- kopje.
2. Qertifikates fiskal - kopje

Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, nga grupi kërkohet që të emërojë njërin nga anëtarët e grupit, si operator për kontakt dhe, së bashku me tenderin e tij, të dorëzojë edhe origjinalin e nënshkruar të marrëveshjes për krijimin e atij grupi.

Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të kenë të drejtën e tyre në pajtim me dispozitat e paragrafit III.2.1). Të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmitë e kërkuara në pajtim me paragrafin III.2.2), te këtij njoftimi.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa:

1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2013-2014-2015) ka qenë prej jo më pak se
   30,000.00 Euro për lot 1
   17,000.00 euro për lot 2

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Raportin ose raportet financiare përkatëse nga një ose më shumë banka (Origjinal ose i Noterizuar).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa:

1. Ofertuesi duhet të prezantoj së paku :
   Dy kontrata në tri vitet e fundit për lot 1.
   Një kontrata në tri vitet e fundit për lot 2.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. **Lot 1**: Ofertuesi duhet të prezantoj së paku Dy referenca te kontratave apo raport të pranimeve për furnizim me Libra (ku specifikohet shuma, lloji i shërbimit, titulli, vendi i shërbimit etj) në 3 vitet e fundit - kopje.
   Lot 2: Ofertuesi duhet të prezantoj së paku Nje referencë te kontratës apo raport të pranimeve për furnizim Librave (ku specifikohet shuma, lloji i shërbimit, titulli, vendi i shërbimit etj) në 3 vitet e fundit – kopje

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi në total €	Vërejtje
1.	N.T.P. "Artini"	Prishtinë	3,199.00 €	JO
2.	N.T.P. "KGT"	Prishtinë	7,968.00 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 11.11.2016, konstatohet se në hapjen e ofertave NUK kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 2 (dy) OE për Lot 2, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Kryesues i komisionit – Irfan Miftari,
- Anëtar i komisionit - Imer Dragusha,
- Anëtar i komisionit – Lindita Dobruna.

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimit:.....25.01.2017-23.01.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....23.01.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësues në përbërje: Irfan Miftari, Imer Dragusha, Lindita Dobruna pasi ka shikuar dosjen e tenderit te OE, ka dal me rekomandim se OE N.T.P. "Artini" është i papërgjegjshëm, nuk ka plotësuar kriteret e domosdoshme në dosjen e tenderit. **Njësia kërkuese ka kërkuar që të anulohet ky tender për arsye se vlera e mjeteve me te cilat është shpallur tenderi nuk ekziston, andaj jemi të obliguar detyrimisht të anulojmë tenderin. Komisioni i vlerësimit e ka marr si të bazuar ketë njoftim ku Njësia kërkuese ka rekomanduar që të vazhdohet ma procedurën e Anulimit të tenderit, me ketë mendim ka pajtuar edhe 3 anëtaret e komisionit vlerësuese.**

Analiza dhe sqarimet e ekspertëve shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi nr. 1:

Autoriteti Kontraktues – **Universiteti i Prishtinës,** gjatë këtij aktiviteti të prokurimit me titull: **"Blerja e librave në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Angleze" Lot 2, me nr. të prokurimit: 90400/16/032/121,** ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike, me vlerë të mesme.

Operatori ekonomik ankues: N.T.P.**"KGT"**, me datë: 22.02.2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-UP-së, për këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, me pretendimet ankimore se është bërë shkelje e dispozitave të LPP-së, dhe atë të nenit: 1 pika 2 dhe 3, nenit 7 pika 1, nenit 51 pika 1, nenit 54 pika 1, 1.1 dhe 1.3, dhe nenit 59 të LPP-së.

AK- Universiteti i Prishtinës me datë: 28.02.2017, ka kthyer përgjigjeje ndaj operatorit ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Arsyetimi:

"Sqarim zyra e prokurimit posedon zotimin e mjeteve ne shumë prej 8,500.00 € për Lot 2 ashtu edhe ka dal edhe Njoftimi për Ritenderimë, anulimi është ber pa dijeninë e zyrës se prokurimit.

Arsyeja pse është përgjysmuar zotimi i mjeteve, zyra e prokurimit nuk ka pasur njohuri, Mirëpo komisioni ka vendosur qe te behet Anulimi i kësaj lende. Kështu ka qen edhe arsyetimi ne Anulimin e Tenderit ".

Prandaj, duke u bazuar në nenin 108/A, paragrafi 10.1 të ligjit 05/-L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/-L-042, për prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, I plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237, Kërkesën për rishqyrtim të OE. "N.T.P. KGT" i REFUZON si të PABAZUAR.

OE ankues për të njëjtin aktivitet të prokurimit ju është drejtuar OSHP-së me ankesë me datë: 01.03.2017, kundër njoftimit për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Sqarimi nr. 2:

Lidhur me pretendimin operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit: 1, 7, 51, 54 dhe 59 të LPP-së:

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së si dhe të nenit 35.2, të UOPP-së, (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve), ku rrjedhimisht thotë:

Neni 35, i UOPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve:
35.2 "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuar, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 10 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderit".

Eksperti shqyrtues sqaron se komisioni i vlerësimit ka tejkaluar afatet kohore për vlerësimin e ofertave më shumë se 30 ditë, pa ndonjë arsye. Hapja e ofertave ka qenë me datë: 11.11.2016, ndërsa vlerësimi i ofertave ka përfunduar me datë: 23.01.2017, që i bie se ky aktivitet i prokurimit është vonuar më shumë se dy muaj. Ndërsa, pretendimet ankimore të OE ankues kualifikohen të bazuara.

Sqarimi nr. 3:

- **Operatori Ekonomik N.T.P. "KGT"**, përmes e-malit të datës: 27.01.2017 ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues UP, ku thuhet: *ju lus qe te na informoni ne lidhje me aktivitetin e prokurimit "Blerja e librave ne Gjuhen Shqipe-Angleze" se pse po zvaritet vlerësimi kur dihet se oferta jone derzuar me date 11.11.2016 dhe kjo periudhë e gjate e vlerësimit bjen ndesh me ligjin e prokurimit te Kosovës.*

- **Prapë Operatori Ekonomik** ankues ka kërkuar nga AK-UP përmes emalit të datës: 21.02.2017, një sqarim në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ku thuhet: *"me ketë deshirojme qe edhe nje here te kerkojme sqarime pasi qe ne kerkesen tone te dates 27.01.2017 nuk na dhate asnjë pergjigjje ne lidhje me vlerësimin e aktivitetit te prokurimit "Blerja e librave ne Gjuhen Shqipe-Angleze". Siq e dinime date 07.12.2016 kemi kërkuar nga ne dokumentat (vertetimat) nga Gjykata dhe nga ATK-ja, me date 09.12.2016 keto dokumente ua kemi sjell ne zyre, nga kjo date nuk kemi asnjë informate me kete aktivitet.*
  Kompania jone mendone de me kete zvaritje po tentoni qe ti beni bishtnim vlerësimit dhe se kjo zvaritje paraqet shkelje te ligjit te prokurimit publik te Kosoves dhe paraqet tejkalim te periudhes te nevojshme per vlerësim.
  Nese deri ne fund te kësaj jave nuk kemi njoftim për vlerësimin e këtij aktiviteti ateher ankesen tone do ta adresojmë ne OSHP".

- **Autoriteti Kontraktues Universiteti i Prishtinës,** ka kthyer përgjigjeje përmes e-mailit të datës: 22.02.2017, ku thuhet: *"te nderuar perfaqesues te OE "N.T.P. KGT" shiqone imellen nga Vera Sopi me dt 23.01.2017. komisioni i vlerësimit është bazuar ne këtë e-mail dhe ka vendosur për Anulim te tenderit. Neser nga ora 10:00 ju presum ne zyre nr.5.*

- ***E-maili nga Vera Sopi*** *i derguar Selman Qorrit permes emailit te dates 23.01.2017, ku thuhet: Përshendetje Selman, fillimisht ju kërkoj ndjese qe nuk e keni qene te informuar, nuk di qfare te ju them per komisionin dhe ndërrimin e tyre, por sa i pwrket lendes per librat ne gjuhen shqipe, është bere njw keqkuptim qysh ne fillim te ri shpalljes.*

  Fillimisht ne kemi pasur te zotuar mjetet nga projekti por ma vone pasi nuk ka pasur ofertues, ne kemi bere ndryshime, kemi anuluar zotimin nga mjetet e projektit dhe kemi zotuar vlern 5000 euro nga mjetet tona buxhetore. Vlera e mjeteve 8500 me te cilat eshte rishpallur tenderi nuk ekziston. Andaj detyrimisht jemi te obliguar te Anulojm lenden për te filluar me shpallje te tenderit ne ketë vit. Vlera e mjeteve te ndara për librat e gjuhes shqipe ne ketë vit është 4000 euro. Uroj qe ky keqkuptim apo keqinformim te mos ju sjell probleme".

Sqarimi nr. 4:

Lidhur me pretendimet tjera të operatorit ekonomik ankues ku thuhet se: *"Arsyeja në vendimin për eliminim është e reme sepse në dosjen e tenderit në faqe 13, te pika 2.4 Vlera e parashikuar është 8,500.00 Euro, kurse oferta jonë është 7,968.00 Euro".*

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar kriterin që ka vendosur në dosjen e tenderit tek pozicioni 2.2 të FDT-së, në vlerë prej 8,500.00 €, për Lot 2, ndërsa OE ankues N.T.P. "KGT", ka ofertuar me çmim 7,968.00 €, d.m.th. edhe ky pretendim ankimor kualifikohet i bazuar.

Megjithatë rekomandimi ynë për AK-në është që ky aktivitet i prokurimit të rivlerësohet edhe njëherë sipas neni 59 të LPP-së, për faktin se OE ankues është brenda planifikimit të mjeteve që ka parapa AK-UP, në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit për Lotin 2.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e librave në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Angleze" për Lot 2, me nr. të prokurimit: 90400/16/032/121,** i rekomandojmë panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuara, ndërsa Autoriteti Kontraktues të anuloj njoftimin për anulim të datës: 06.02.2017, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**